



RAMADAN FIRAJ

Kur këshillimi i karrierës nuk është thjesht një zyrë

Kur pyetet për ëndrrën e fëmijërisë, ai nuk ngurron: *"Gjithmonë e kam parë veten në kërkim shkencor"*. Një rrugë jo e zakonshme për shumë të rinj shqiptarë, por për të ishte drejtimi natyral, i ushqyer nga mënyra si ishte rritur dhe nga vlerat e familjes.

Ky student i Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF), sot pjesë e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, tregon se edhe ëndrrat më të qarta përballen me realitetin. *"Në vitin tim të parë, nuk kishte një zyrë të dedikuar për këshillimin e karrierës. Kjo strukturë u krijua më vonë, por ndikimi i saj ishte i ndjeshëm,"* kujton ai.



Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:

Zbatuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



HELVETAS



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Zgjedhja e profesionit nuk erdhi si ndriçim i papritur. Ai e përshkruan si një proces që shpesh shoqërohej me dyshime dhe analiza alternative.

"Gjatë vitit të fundit të studimeve, me ndihmën e profesorëve dhe Dekanatit, u paraqita me dy mundësi konkrete: punë në Institutin e Gjeoshkencave ose në atë të Fizikës Bërthamore. Aty fillova ta ndjej vërtet se po shkoja drejt rrugës sime." Megjithatë, ka pasur edhe vendime të qarta për të mos ndjekur disa drejtime. E përjashtova menjëherë idenë për të ndjekur programimin si profesion. *"Python" më pëlqen shumë, por vetëm si mjet ndihmës për kërkimin tim shkencor, jo si qëllim më vete."*

Këshillimi i karrierës, për të, ishte një pikë kthese. Jo vetëm që i hapi dyer reale drejt punësimit, por ndikoi edhe në mënyrën si ai e sheh veten në të ardhmen. *"Sot e projektoj veten si dikush që me pasion dhe ndershmëri jep kontributin e tij në shoqëri, në përputhje me përgjegjësitë që i ngarkon profesioni."*

Por, a ka pasur ndonjë moment paqartësie? *"Patjetër! Si çdo student, edhe unë kam pasur momente kur nuk dija çfarë doja të bëja. Madje tani, në marrëdhënie pune, shpesh reflektoj nëse i kam vënë vetes më shumë barrë sesa duhej."*

I pyetur nëse ndonjëherë ka ndjerë se shoqëria e ka shtyrë drejt një rruge që nuk ishte e tij, ai bën një ndarje të qartë: *"Nëse flasim për sistemin shoqëror dhe ekonomik, padyshim që po. E konsideroj veten me fat, por shumë të rinj nuk arrijnë të punësohen në fushën që studiojnë. Ndikimi i këshillimit të karrierës ka qenë vendimtar edhe pse, fatkeqësisht, nuk ishte aty që në fillim të rrugëtimit tim."*

Nga të gjitha zbulimet për një drejtim të ri, njëri ishte i papritur: Spektroskopia e Fluoreshencës së Rrezatimit X, teknikë që nëpërmjet bashkëveprimit të rrezatimit x me lëndën në nivel atomik studion përbërjen e materialeve të ndryshme. *"Nuk kisha dëgjuar asnjëherë për këtë fushë derisa u përfshiva në temën e Masterit. Sot është një ndër fushat që më tërheq më shumë"*.

Në fund, i mbetur pa pendesa për zgjedhjet e bëra, ka vetëm një mesazh për versionin e tij 14-vjeçar: *"Vazhdo kështu. Në fund, gjithçka është në dorë të Zotit."*

Dhe ndërsa rruga e tij tashmë është më e qartë, ai nuk harron të përmend ndikimin pozitiv të prindërve dhe miqve, të cilët e kanë përkrahur me entuziazëm. Me një ndjesi të qartë paqeje dhe vetëbesimi, ai përmbyll: *"Jo vetëm që nuk kam më dyshime, por sot ndihem më i qetë dhe më i sigurt për rrugën që kam zgjedhur. Jam mirenjohës ndaj Zyrës së Karrierës dhe Katedrës në FIMIF, Departamentit të Fizikës për pranimin si seminarist i jashtëm në lëndën e Fizikës"*.

